



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 819 Prot.

Lezhë, më 20 . 01 . 2021

VENDIM

Nr 02 , Datë 20 / 01 / 2021

**“PËR
MIRATIMIN E PAGESËS SË QIRASË SIPAS VLERËS SË TREGUT TË LIRË, PËR
FAMILJET E EVAKUARA NGA BANESAT E TYRE TË DËMTUARA NGA
TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të kushtetutës, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 30 dhe nenit 42, pika 1, shkronjat “b” dhe “d”, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, vendimit nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar, Aktit normativ.nr.8, datë 07.12.2019 “Për përdorimin e procedurës së përshpejtuar për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasoje e fatkeqësisë natyrore, termetit të datës 26.11.2019, i ndryshuar me Aktin normativ nr.37, datë 24.12.2020 “Për një ndryshim në aktin normativ nr.8, datë 07.12.2019 të Këshillit të Ministrave”, VKB nr.115, datë 26.08.2020 “Për miratimin e listës së subjekteve përfituese për grante rindertimi për shtëpitë individuale dhe banesa në ndërtesa (Pallate), me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit në Bashkinë Lezhë”, VKB nr.141, datë 14.10.2020 “Për miratimin e listës së subjekteve përfituese për grante rindertimi për shtëpitë individuale dhe banesa në ndërtesa (Pallate), me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit në Bashkinë Lezhë”, VKB nr.112, datë 11.12.2019 “Për ndryshime të VKB-së nr.111, datë 06.12.2019 “Për miratimin e pagesës së plotë të qirasë sipas vlerës së tregut për familjet që janë dëmtuar nga termeti i datës 26.11.2019”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

VENDOSI :

- 1- Miratimin e pagesës së plotë të qirasë, deri në momentin që familjeve u rikonstruktohen ose rindertoen banesat, sipas vlerës së tregut të lirë, për familje, banesat e të cilave janë dëmtuar si rezultat i tërmetit të datës 26.11.2019, sipas Lidhjes nr.1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- 2- Afati i pagesës së qirasë mujore për familjet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi,

fillon nga muaji Dhjetor 2020.

- 3- Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social të ndjekë të gjithë procesin dhe monitorojë pagesën e qirasë për familjet përfituese, si dhe të njoftojë strukturat përgjegjëse për ndërprerjen e kësaj pagese, në rast se këto familje sistemohen përfundimisht në një banesë, përpara afatit të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.
- 4- Familjet përfituese sipas këtij vendimi, përjashtohen nga pagesa e taksës së ndërtesës në masën e parashikuar nga ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.
- 5- Efektet financiare sipas këtij vendimi do të përballohen nga Fondi i Emergjencave Civile parashikuar në buxhetin e Bashkisë Lezhe për vitin 2021.
- 6- Ngarkohen Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e këtij vendimi.
- 7- Vendimet e mëposhtme:
 - VKB nr.118, datë 16.12.2019
 - VKB nr.127, datë 31.12.2019
 - VKB nr.18, datë 05.02.2020
 - VKB nr.34, datë 26.02.2020
 - VKB nr.49, datë 10.04.2020
 - VKB nr.53, datë 08.04.2020
 - VKB nr.77, datë 09.06.2020
 - VKB nr.116, datë 26.08.2020
 - VKB nr.137, datë 30.09.2020
 - VKB nr.158, datë 19.11.2020që shtrijnë efektet financiare në vitin 2021, shfuqizohen.
- 8- Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

**SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ**



**KRYETARI
ERNEST RAKAJ**

